



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (3)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të aftësojë studentin në një nivel mbi mesataren të gjuhës italiane. Percorso Italia. Niveli B 1 bën të mundur familjarizimin me strukturat e italishtes dhe përputhet me parametrat e vendosura sipas kuadrit të Bashkimit European të gjuhëve.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Lënda ofron aftësinë për të përvetësuar koncepte të nivelit B 1 në italisht. Kjo veprimtari, përfshin fusha të tilla, si : gramatika, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, fjalori.
- 2.Lënda përftohet përgjatë kursit semestral akademik. Ajo ofron gjithashtu aftësinë për të komunikuar në gjuhën italiane; për t'u orientuar, kërkuar, përshkruar e dialoguar individualisht, apo ne grup; lënda u ofron studentëve një komunikim dhe socializim të thjeshtë në një ambient ku flitet gjuha italiane.
- 3.Lënda përcjell tek studentët aftësinë e të qenit kreativë, duke debatuar, mbështetur dhe arsyetuar në mënyrë kritike dhe autokritike në gjuhën italiane, ky nivel përcjell informacion të larmishëm në auditor, i cili shpesh kapërcen dhe tipologjinë tematike te metodes në fjalë;
4. Të krijoj aftësi për të vlerësuar dhe vetvlerësuar, bashkshoqëron dhe aftësinë për të rrëfyer ndodhi të së shkuarës, për të konsultuar informacione te ndryshme ne faqe web, apo njoftime nëpër gazeta e revista duke zgjeruar kështu linjën e njohurive dhe angazhimeve akademike përmes gjuhës së huaj të dytë;
- 5.Lënda përcjell mesazhin e familjarizimit dhe përdorimit të teknikave e dimensioneve gjuhësore në procesin e të mësuarit dhe të të nxënit.

Rezultatet e pritshme:

Studenti do të jetë i aftë:

- 1.Të komunikojë me shkrim dhe me gojë në një nivel mbi mesataren gjuhësore, duke u shprehur në formë të përparuar gojore dhe të shkruar në gjuhën italiane.
- 2.Të kuptojë bashkëbisedime mbi ngjarje të ndryshme të jetës së përditshme.
- 3.Të kuptojë kur një njeri shpreh habi, pakënaqësi apo nuk miraton dicka.